



Lajmëtari i Radio Marisë

Mars 2012

Viti IV, Nr. 3

LAJMËRIMI I ZOTIT

Caktimi i datës së fillimit të vitit në përputhje me fillimin e pranverës dhe rizgjimit natyror të jetës ishte një praktikë e vjetër, shumë e përhapur në kultura të ndryshme. Viti i ri i caktuar më 1 janar hyri në përdorim vetëm në vitin 1582 me hyrjen në fuqi të kalendarit aktual të miratuar nga Papa Gregori XIII. Megjithatë, në shumë vende, dhe në veçanti në Republikën e Venedikut, viti fillonte më 1 mars. Vetëm nëse i numërojmë muajt nga marsi, atëherë, shtatori është vërtet muaji i shtatë, tetori i teti, nëntori i nënti dhe dhjetori i dhjeti. Në shumë vende, në fakt, viti i ri ishte caktuar pikërisht më 25 mars, festa liturgjike e Lajmërimit të Zotit, si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim. Pra, në të kaluarën, ky solemnitet gëzonte një atmosferë të veçantë feste, risie, urimi dhe shprese të gëzueshme. Pra, viti fillonte me përkujtimin e ngjarjes unike dhe të papërsëritshme që është qendra historisë njerëzore: çasti i parë i mishërimit të Krishtit, Birit të Hyjit, në barkun e Marisë Virgjër. Në këtë mënyrë ndryshon gjithçka, ajo çka mbizotëron nuk është më lidhja me ciklet stinore në përsëritjen e tyre të pandryshueshme të lulëzimit pranveror që përfundonte pashmangshmërisht me rënien vjeshtore të gjetheve dhe gjumin dimëror. Lajmërimi i Zotit kremton një risi absolute që ka ndodhur një herë e përgjithmonë pa pasur mundësi të përsëritet: Hyji Atë, në Jezu Krishtin, i bëri të vetat fatet e njerëzimit, që në Marinë Virgjër thotë “Po”-në e vet. Ndryshimi i ndodhur nga mishërimi i Jezusit, Biri i Hyjit dhe Biri i Marisë, përcakton në histori një kohë ‘para Krishtit’ dhe një kohë ‘pas Krishtit’, që nuk është thjesht një fakt kohor, por një ndryshim i cilësisë për jetën e njerëzve. Në histori nuk është se nuk ndodhin më ciklet përsëritëse të stinëve, por ajo i hapet një përparimi që e çon vazhdimisht drejt Mbretërisë së Hyjit, drejt ringjalljes, drejt jetës së pasosur.

Lajmërimi i Zotit, pra, është vërtet një festë me kuptime të shumta e të thella. Këto shtohen edhe më tej, nëse merret parasysh se pjesa ungjillore, që na vjen nga Luka Ungjilltar, jo vetëm se mund të lexohet, por shumë lehtë mund edhe të shikohet. Në fakt, besoj se Lajmërimi i Zotit, së bashku me Krishtlindjen dhe Kryqëzimin, është një prej skenave ungjillore më të punuara në mënyrë absolute nga piktorët e çdo kohe.

Duke vëzhduar mirë cilindo prej këtyre imazheve të shenjta, mund ta meditojmë misterin e mishërimit duke e rijetuar atë përmes secilit personazh të përfshirë në të. Pika e fillimit është Hyji Atë. Nga Ai vjen nisma për t’i ofruar njerëzimit një rast përfundimtar për shpëtim. E gjithë historia “para Krishtit” ka qenë përgatitja dhe e gjithë historia “pas Krishtit” është kryerja e këtij shëlbimi. Është Ati ai që e dërgoi krye-engjëllin Gabriel për të marrë bashkëpunimin e lirë të Marisë dhe është po ai që me plot besim e dërgon Shpirtin Shenjt që gjithçka të fillojë.



Krye-engjëlli Gabriel është bartësi i një përshëndetjeje të gëzuar dhe i një mesazhi kërkues. Qëndrimi i tij përpara Virgjërës Mari shpreh të gjithë respektin e Krijuesit përpara lirisë së krijesës së vet dhe se ai di të presë që nga goja e Marisë të dalë ajo “Po” që e mirëpret jetën e re. Virgjëra, në shqetësimin e saj, shfaqet si një njeri i vetëdijshëm që e pyet veten për domethënieën e ngjarjeve dhe fjalëve. Nuk është pre e entuziazmeve të lehta. Nuk paralizohet nga frika. Pasi engjëlli e shaplli si “hirplote”, tani ajo po mbushet me Fjalën e Hyjit që bëhet mish në të. Shpirti Shenjt, duke u paraqitur në formën e pëllumbit, ka nisur të zbrësë tashmë drejt asaj që di të jetë një tempull i gatshëm për ta mirëpritur. I vetmi që nuk na është dhënë ende për t’u parë është Jezusi i vogël, që megjithatë shumë shpejt, në takimin me Elizabetën, do të japë shenja të pakundërshtueshme të pranisë së vet vepruese, edhe pse i fshehur në barkun e Marisë.

Duke u takuar me secilin aktor të kësaj drame të madhe të shenjtë, hyjmë edhe ne në brendësinë e një misterit, që nëse nga njëra anë na tejkalon krejtësisht përse i përket kuptimit, nga ana tjetër na përfshin në mënyrë të plotë si marrësit e dhuratës së Hyjit, duke na bërë të aftë që ta themi edhe ne një “Po”, e cila duke u bashkuar me atë të Marisë i jep shpresë të re edhe jetës tonë sot. Gëzuar Festën e Lajmërimit të Zotit dhe e paçi gjithmonë bekimin e Hyjit!

Atë Flavio Cavallini, ofm

Në këtë numër do të lexoni:

Ndihmë teknike nga RM Botërore

fq. 2

Dora-dorës në shpalljen e Ungjillit fq. 3

Takimet për ungjillëzimin e ri në Lezhë

fq. 2

Titujt dhe raret e programeve kryesore që transmetohen në fq. 4

Radio Maria pasurohet me programe të reja dhe vullnetarë të rinj fq. 2

Radio Marinë Shqiptare

TAKIMET PËR UNGJILLËZIMIN E RI NË LEZHË

Në përgatitje të Vitit të Fesë 2012-2013, të shpallur nga Papa Benedikti XVI, Dioqeza e Lezhës ka ngritur një Komision Dioqezan për Ungjillëzimin e Ri të përbërë nga përfaqësues të bashkësive të ndryshme rregulltare të Dioqezës dhe nga laikët. Ky komision po organizon takime të përmuajshme me besimtarët e famullive dhe lëvizjeve të ndryshme brenda Dioqezës në Katedralen e Shën Nikollës në Lezhë. Lutja dhe këngët e lavdit shoqërohen me katekeza që trajtojnë tema të ndryshme që lidhen me Ungjillëzimin e Ri. Nuk mungojnë as dëshmitë e besimtarëve dhe rregulltarëve të ndryshëm, që i pasurojnë takimet.

Takimi i parë, me temë “Nxitja e Kishës për Ungjillëzimin e Ri”, u zhvillua në datën 4 dhjetor 2011 dhe u drejtua nga Nunci Apostolik në Shqipëri, Imzot Ramiro Moliner Ingles dhe Ipeshkvi i Dioqezës së Lezhës, Imzot Ottavio Vitale. Përveç paraqitjes së fjalës së Atit të shenjtë lidhur me shpalljen e Vitit të Fesë, Nunci Apostolik paraqiti edhe librin “Krishterimi si dashuri e Zotit”, një katekizëm për të rinjtë i punuar nga Don Lorenzo Rossetti. Të pranishmit u njohën edhe me përbërjen e Komisionit Dioqezan për Ungjillëzimin e Ri.

Takimi i dytë, me temë “Nuk më vjen turp për Ungjillin”, u zhvillua më 8 janar 2012. Atë Flavio Cavallini bëri një komentim të Librit të Veprave të Apostujve, duke u ndalur te kthimi i Shën Palit dhe ndikimin që pati ai në jetën e Kishës.

Takimi i tretë, me temë “ Kush është njeriu i sotëm, të cilit do t’ia shpallim Ungjillin”, u zhvillua më 19 shkurt 2012. Don Lorenzo Rossetti mbajti një katekezë, ku foli për fetarizmin dhe fenë e krishterë në një botë të shekullarizuar, një temë kjo që ngjalli shumë interes te pjesëmarrësit. Lutjet në Shpirtin Shenjt dhe këngët e lavdit drejtohen nga Bashkësia Tempulli i Zotit.

Radio Maria i ka transmetuar drejtpërsëdrejti këto tri takime dhe do të bëjë edhe transmetimin e takimeve të tjera, që do të zhvillohen përkatësisht më 18 mars, 22 prill, 13 maj dhe 10 qershor 2012. Takimet fillojnë gjithmonë në orën 15:00 dhe zgjasin rreth 90 minuta. I ftojme të gjithë dëgjuesit e Radio Marisë në Dioqezën e Lezhës që të marrin pjesë personalisht në to për të mësuar më shumë mbi Ungjillëzimin e Ri.

Maria Katerina

NDIHMË TEKNIKE NGA FAMILJA BOTËRORE E RADIO MARISË



Radio Maria Shqiptare është pjesë e Familjes Botërore të Radio Marisë, e cila ka për qëllim të vetin edhe formimin profesional të punëtorëve të radiove lokale që angazhohen kryesisht në teknike dhe transmetim. Në këtë kuadër, z. Adrian Ioan, Teknik i Audios i Familjes Botërore të RM-së, ishte në Shqipëri nga data 29 janar deri në datën 4 shkurt, për të na ndihmuar lidhur me përmirësimin e cilësisë së regjistrimeve, transmetimeve dhe punës së aparaturave teknike.

Pas vizitave që u bëri tre studiove tona në Tiranë, Shkodër dhe Lezhë, ku bëri një përditësim të sistemeve dhe aparaturave transmetuese, ai zhvilloi edhe një kurs intensiv 3-ditor me punëtorët e radios lidhur me përdorimin sa më të mirë të aparaturave dhe programeve të transmetimit. Në këtë kurs, që u zhvillua në selinë e Radio Marisë në Tiranë, morën pjesë Enriku, Orselina, Leonida, Flora, Maria Katerina dhe në disa seanca edhe Don Preka. Në këtë kurs u thelluan njohuritë e pjesëmarrësve për zërimin, përdorimin e saktë të mikrofonave, programet e ruajtjes dhe të përpunimit të transmetimeve në kompjuter, arkivit, kompjuterët ndihmës dhe për shumë çështje të tjera të nevojshme. Ky kurs ishte shumë i dobishëm, sidomos tani që radioja është në një fazë të re zgjerimi e zhvillimi. E falënderojmë Familjen Botërore të RM-së për kujdesin që e ka për RM Shqiptare dhe për ndihmesën e saj në kohën e duhur.



Orselina

RADIO MARIA PASUROHET ME PROGRAME TË REJA DHE VULLNETARË TË RINJ

Gjatë 24 orëve të një dite, në Radio Mari, transmetohen emisione të ndryshme për të gjitha moshat. Emisionet e reja po zënë vend gjithmonë e më shumë në programin e radios. Që nga festa e Krishtlindjes deri në muajin shkurt, programi është përtërirë me këto emisione:

- “Zbulimi i Hyjit Atë”
nga Imzot Gjergj Frendo
- “Së bashku me Krishtin në jetë”
nga Elsa
- “Katekizmi yt”
nga Antonino
- “Sekreti i Rruzares”
nga Dileta dhe Izabela
- “Zbulimi i fesë së Krishterë”
nga Don Lorenzo Rossetti
- “Pyetje që i bëjnë fëmijët për Hyjin”
nga Paola Qyrsaqi & Paola Ejlli,
që ka nisur nga e Mërkura e Përhime

Gjithashtu, në muajin mars, do të nisë emisioni i ri “Ungjilli i Jetës”, që do të drejtohet nga Maria Katerina. Do të trajtohen tema të ndryshme, të cilat synojnë rikthimin e kulturës së jetës në shoqërinë tonë.

Gjatë komunikimit që e kemi me dëgjuesit, si përmes telefonit ashtu edhe përmes kontakteve personale në studiot e radios në Shkodër, Tiranë dhe Lezhë, ata dëshmojnë se nuk ndihen më të vetmuar dhe shumë të sëmurë kanë gjetur shërimin e shpirtit. Të gjithë shprehin kënaqësinë për emisionet e ndryshme që transmetohen në Radio Mari.

Takimet me vullnetarët e rinj zhvillohen rregullisht sipas këtyre orareve:

Lezhë – të hënën, në orën 13:30-14:30

Tiranë – ë mërkurën, në orën 15:00-16:00

Shkodër – të premten, në orën 16:00-17:00

Në këto takime, vullnetarët shprehin mendimet e tyre për emisionet që transmetohen, në veçanti për emisionet e të rinjve dhe të fëmijëve. Radio Maria është e hapur për çdo njeri që dëshiron t’i vendosë talentet e veta në shërbim të Zotit dhe të Zojes së Bekuar për rritjen e një veprë të madhe e të rëndësishme ungjillëzimi, me qëllimin e vetëm që Fjala e Zotit të mbërrijë te çdo njeri e kështu të përmbushet porosia e Jezusit: **“Dilni në mbarë botën e predikojani Ungjillin të gjithë njerëzve” (Mk 16, 15).**

Leonida

DORA-DORËS NË SHPALLJEN E UNGJILLIT

Të dashur lexues të "Lajmëtarit të Radio Marisë". Hyji që është dashuri çdo ditë na gëzon me dhurimin e kësaj dashurie. Ai na fton që çdo dhuratë, që e sjell në jetën tonë, ta pranojmë dhe të bëhemi bashkëpunëtorë në mirëmbajtjen dhe rritjen e saj. E një ndër dhuratat më të bukura, që Hyji ka sjellë në jetën tonë, është Radio Maria. Ka mbi 8 vjet që ajo po rritet çdo ditë e më shumë, duke sjellë gëzim në çdo zemër që e takon dhe e pranon. Mjafton që ju ta takoni vetëm një herë dhe ajo bëhet pjesë e pandarë e jetës tuaj. E them këtë, sepse kjo më ka ndodhur mua dhe iu ka ndodhur me mijëra e mijëra dëgjuesve, që tani janë dëgjues e bamirës të rregullt të saj.

Kjo është dhurata që Hyji ma ka dhuruar mua. Por, lind pyetja se këtë dhuratë të Hyjit a mjafton që ta mbaj vetëm për vete apo t'ua dhuroj edhe të tjerëve? A mos vallë duhet të mjaftohem me gëzimin, sepse unë e gjeta burimin e Ujit të gjallë dhe kjo mjafton? Jo, të dashur vëllezër dhe motra, kjo nuk duhet të ndodhë assesi. Këtë Hir, që Hyji e solli tek unë, duhet t'ua dhuroj edhe të tjerëve. Këtë burim të Ujit të gjallë duhet t'ua tregoj dhe të tjerëve. Sa gëzim është kur edhe vëllai dhe motra jonë marrin pjesë në këtë dhuratë të Hyjit.

Familja botërore e Radio Marisë po e jeton Vitin e tretë Promovimit për të gjithë dëgjuesit e saj në mbarë botën. Viti i kaluar edhe në Radio Marinë Shqiptare, solli një rritje të vogël në dëgjueshmëri, bashkëpunim dhe mbështetje financiare.

Në vitin 2012 po përgatitemi për të kremtuar "Vitin e Fesë" që na dhuroj Papa Benedikti XVI. E duke u nisur nga fjalët e Atit të shenjtë, që Radio Maria është instrument i mirë për ungjillëzimin e popujve, kjo na vë, të gjithë neve, dëgjuesve, vullnetarëve dhe bamirësve të saj, përballë një pune edhe më të madhe. Të gjithë duhet të vendosemi, me aq sa mundemi, në shërbim të rritjes së Radio Marisë, të këtij tempulli të Fjalës.

Edhe në këtë fillim të vitit po përpiqemi më aq sa kemi mundësi e dije ta rrisim për çdo dëgjueshmërinë e Radio Marisë, duke e bërë të pranishme tek dëgjuesit e ri dhe bashkëpunëtorët. Deri tani, pothuajse çdo të diel, duke filluar nga Jubica e Koplikut deri në Durrës, vullnetarët e studiove lëvizëse të ftuar nga famulltarët, kanë mundësuar transmetimin e Meshës së shenjtë. Përdorimi i teknologjisë 3G e ka rritur edhe më shumë mundësinë dhe cilësinë e transmetimit. Vlen të theksohet fakti se po punohet shumë në disa zona ku deri tani Radio Maria nuk ka pasur vullnetarë. Tashmë kemi vullnetarë të rinj në Katund të Kastriotit, Gur i zi, Rraboshtë, Durrës dhe Torovicë.

Gjatë muajit janar, Radio Maria ishte e pranishme në Dioqezën Shkodër-Pult, për transmetimin e Meshës së shenjtë dhe promovimin e radios, në këto famulli:

08 janar – Famullia e "Shën Ilisë", Bërdicë.

15 janar – Famullia e "Të Ngjiturit e Zojës në Qiell" në Jubicë të Malësisë së Madhe.

22 janar – Famullia "Nënë Tereza" në Hot të Ri.

29 janar – Famullia "Don Bosko" në Shkodër.

I falënderojmë të gjithë famulltarët për bashkëpunimin me Radio Marinë, porosinë që kanë dhënë dhe mirënjohjen e shprehur për Radio Marinë dhe dëgjuesit e saj, për të sëmuret dhe të vetmuarit. Të gjithë e kanë vlerësuar rolin që luan Radio Maria në ungjillëzimin e popullit shqiptar dhe kanë uruar për një punë edhe më të suksesshme në vazhdim, të mbushur me

hiret dhe bekimet e Zotit. Edhe besimtarët, pak a shumë të organizuar me ndihmën e disa vullnetarëve që ndihmuan për transmetimet dhe promovimin e radios në këto famulli, na kanë pritur mirë dhe kanë marrë pjesë aktive në ato pak veprimtari që kemi arritur t'i bëjmë në këto transmetime të drejtpërdrejta.

Takimet me vullnetarët e terrenit tani kanë filluar të bëhen të grupuara sipas zonave. Aty po organizohet edhe më mirë promovimi i radios dhe po koordinohet puna mes vullnetarëve. Si gjithmonë, të udhëhequr nga provania e Hyjit, shembulli i Nënës sonë qiellore dhe Kisha e shenjtë, në këtë vit të ungjillëzimit, puna e vullnetarëve është përqendruar në shpalljen e Ungjillit. Kjo bëhet duke trokitur te familjarët, fqinjët, në lagje e në fshat, shkolla dhe ndërmarrje, duke ia shpallur njerëzve se Hyji na ka mundësuar që, nëpërmjet Radio Marisë, të bashkohemi në lutje dhe në dëgjimin e Fjalës. I peshkvijtë dhe meshtarët, rregulltarët e rregulltarët, laikët dhe fëmijët, me shumë dashuri, e përcjellin Fjalën e Hyjit, përmes Radio Marisë, pa ndërprerje gjatë 24 orëve të ditës. E kjo dhuratë për popullin tonë nuk ka kufij. Ajo tashmë përmes internetit, në www.radiomaria.al, mbërrin te çdo shqiptar në mbarë botën. Gjithashtu, Radio Marinë e gjeni edhe Facebook në adresën Radio Maria Albania. Meditimi dhe shenjtë i ditës, që paraqiten aty për çdo ditë.

Krahas punës që po bëjmë dita-ditës që Radio Maria të dëgjohet nga çdo familje, së bashku me vullnetarët e terrenit po punojmë që dëgjuesit të luten së bashku, sepse familja, kur lutet së bashku, mbetet e bashkuar, thoshte Nënë Tereza. I falënderojmë të gjithë vullnetarët që janë angazhuar për ta çuar Lajmëtarin e Radio Marisë çdo muaj në dorën e bamirësve. Tani po punojmë për verifikimin e bamirësve të rregullt të radios, hap ky mjaft i rëndësishëm që mundëson një ecuri edhe më të mirë të jetës së radios. Pothuajse në të gjitha fshatrat, ku dëgjohet Radio Maria, gjenden vullnetarët e Radio Marisë, të cilët ju shërbejnë për çdo nevojë që ju keni lidhur me radion. Ata ju sjellin gazetën, fletëpalosjet, kalendarin, librat dhe atyre mund t'ia jepni edhe kontributet tuaja për radion gjithmonë në këmbim të faturës së radios.

Para pak ditësh, patëm një takim me të rinjtë, që janë vullnetarë të studiove lëvizëse e që ndihmojnë në transmetimin e Meshëve në zonat përkatëse dhe në promovimin e radios. Disa prej tyre, duke qenë studentë në fakultetet e ndryshme të Shkodrës, po koordinojnë punën, për ta promovuar Radion edhe te studentët e tjerë në fakultete dhe konvikte. Disa vullnetarë, që janë punonjës në fabrikat e qytetit, po koordinojnë punën që në të ardhmen të zhvillohen takime promovimi edhe me punonjësit e këtyre fabrikave.

Të dashur lexues, Radio Maria është dhurata më e çmuar që Hyji na e ka dhuruar. Të gjithë e kemi pranuar dhe po e pranojmë me gëzim. A mjafton kjo? Jo. Kjo dhuratë, krahas pranimit që i kemi bërë, ka nevojë për ndihmën tonë që të rritet edhe më shumë. Prandaj, në këtë kohë të Ungjillëzimit të ri, le të lutemi së bashku, të punojmë së bashku, dhe ta japim secili kontributin tonë, që Fjala e Zotit dhe dashuria e Tij të përhapet në mbarë popullin shqiptar dhe gëzimi ynë të jetë edhe më i madh.

Roza dhe Fredi

Lajmëtari i Radio Marisë
është organ i
Shoqatës Radio Maria.

Tiranë

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 4
Fushë Kërçik, Babrru, Paskuqan
Tiranë, Shqipëri
+355 4 2 346 346

Shkodër

Sheshi Papa Gjon Pali II
Shkodër, Shqipëri
+355 22 24 08 52

Lezhë

Sheshi Besëlidhja
Lezhë, Shqipëri
+355 215 24 970

E-mail: info@alb.radiomaria.org

Përgjegjës

Don Prekë Lazraj

Radio Maria,

Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde,
mund të dëgjohet në:

Rrëshen e rrethina

FM 100.7 MHz

Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat

FM 91.4 MHz

Shkodër, Podgoricë, Ulqin

FM 102.2 MHz

Lezhë, Laç të Kurbinit, Mamurras

FM 89.6 MHz

Pukë, Fushë Arrëz, Tropojë,

Kukës dhe Kosovë

FM 90.0 MHz

në internet

www.radiomaria.al

PROGRAMET KRYESORE TË RADIO MARISË SHQIPTARE

Çdo ditë, ora 07:30 - Mesha e Shenjtë

Pesë minuta me Zotin

Çdo ditë, ora 14:00 - Udha e Kryqit

Çdo ditë, ora 21:00 - Rruzarja e Shenjtë

E hënë, ora 19:00 - T Emisjoni për fëmijë

E hënë, ora 20:00 - Vatra Biblike

*Emision i përjavshëm i drejtuar nga Atë Flavio Cavallini
me pjesëtarët e famullisë 'Zoja Nunciatë' në Lezhë.*

E hënë, ora 23:00 - Një ekzorciat tregon

Emision i përjavshëm i drejtuar nga Don Preka.

E martë, ora 20:00 - Me të rinjtë dhe për të rinjtë

Emision i përdyjavshëm i drejtuar nga Don Roberti.

E mërkurë, ora 18:30 - Të rinjtë kërkojnë thesarin

Katekezë e përjavshme për të rinj e drejtuar nga Motër Miki.

E mërkurë, ora 20:00 - Në udhëtim me Shën Palin

Emision i përjavshëm i drejtuar nga Atë Ndue Kajtazi.

E enjte, ora 20:00 - Zbulimi i Hyjit Atë

Emision i përdyjavshëm i drejtuar nga Imzot George Frenzo.

E enjte, ora 20:00 - Emision për familjen

Emision i përmuajshëm i drejtuar nga Imzot Ottavio Vitale.

E premte, ora 20:00 - Portrete shenjtërisht

Emision i përjavshëm i drejtuar nga Don Dritani.

E shtunë, ora 20:00 - Shpjegimi i Fjalës së Zotit për ditën e diel

Emision i përjavshëm i drejtuar nga Don Preka.

E shtunë, ora 09:00 - Hap pas hapi në jetë

Emision i përjavshëm i drejtuar nga Dominika.

E shtunë, ora 21:00 - Në udhëtim me Krishtin

Emision i përjavshëm drejtpërdrejt me studion e RM-së në Detroit, SHBA.

E diel, ora 20:00 - Mrekullitë e Meshës së Shenjtë

Emision i përdyjavshëm i drejtuar nga Don Preka.

E diel, ora 20:00 - Feja e krishterë, gëzimi për një lajm të mirë

Emision i përdyjavshëm i drejtuar nga Don Lorenzo Rossetti.

PRO CREDIT BANK

LLOGARIA NË **EURO 600388970102**

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL45209516090000600388970102

LLOGARIA NË **LEK 600388970001**

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL56209516090000600388970001

INTESA SANPAOLO BANK

LLOGARIA NË **EURO 1043631803**

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL25208110080000001043631803

LLOGARIA NË **LEK 1043631801**

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 79208110080000001043631801

NË ZVICËR

Duke telefonuar në numrin:
0900123411 dhuron 5 Franga

Në bankën **CREDIT SUISSE**

RADIO MARIA

LLOGARIA NË **CHF 361173-10-1**

IBAN: CH1804835036117310001